



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 9612 prot.

Vlorë, më 19.06 2024

PROJEKT -VENDIM

PËR

**MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA
DJEGIA SI DHE HUMBJEN E JETËS TË Z.THOMA LOLI NË BANESËN E
Z.JURGEN LOLI DHE SHPËRBLIMIN FINANCIAR NGA ANA E
BASHKISË VLORË.**

Këshilli i Bashkisë Vlorë në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, neni 9/1 pika b, neni 29/1, neni 54 pika dh ,të ligjit nr.45/2019 datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”,në VKM Nr. 329 data 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” paragrafi III/ë dhe pika 3/a, pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Financës dhe Këshilli i Qarkut Vlorë,

VENDOSI:

1. Të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e z.Jurgen Loli, e ndodhur në lagjen “Osman Haxhiu”, Rajoni Nr.3, Bashkia Vlorë, në datën 06.03.2024, sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë përkatësisht në masën:

A. 385.118 (treqind e tetëdhjet e pesë mijë e njëqind e tetëmbëdhjetë) lekë për punime ndërtimi (770.236x50%).

B. 299.709 (dyqind e nëntëdhjet e nëntë mijë e shtatëqind e nëntë) lekë për mobilje dhe pajisje elektorshtëpiake.

C. Të miratojë vlerën financiare për humbjen e jetës të z.Thoma Loli në banesën e z.Jurgen Loli në masën :

- 500.000 (pesëqind mijë) lekë

- Shpërblimi financiar do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile të Bashkisë Vlorë.
- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë-Buxhetit dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile pranë Bashkisë Vlorë.
- Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015,neni 55 pika .

KRYETAR

Ermal Dredha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 9612 prot.

Vlorë, më 19.062024

RELACION

PËR

PROJEKT-VENDIMIN “MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA DJEGIA SI DHE HUMBJEN E JETËS TË Z.THOMA LOLI NË BANESËN E Z.JURGEN LOLI DHE SHPËRBLIMIN FINANCIAR NGA BASHKIA VLORË”

Në zbatim të VKM Nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, në Bashkinë Vlorë date 28.03.2024 ka paraqitur kërkesën z.Jurgen Loli me nr 4648 prot për shkakë të djegies së banesës dhe humbjen e jetës të z.Thoma Loli në objektin e ndodhur në lagjen “Osman Haxhiu” Rajoni 3 Bashkia Vlorë.

Komisioni i Bashkisë Vlorë i ngritur me Urdhërin e Brendshëm Nr.15 datë 12.01.2024 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë ,shkoi në banesë për të konstatuar dëmet e shkaktuara nga djegia.

Mbas hartimit të proces-verbalit të konstatimit të gjendjes së banesës në datë 03.04.2024, është vijuar me shkresën përcjellëse me Nr.4648/1 prot, datë 17.04.2024 “Dërgohet dokumentacioni për banesën e djegur të z.Jurgen Loli” në Këshillin e Qarkut Vlorë për të vazhduar me preventivat e vlerësimit të dëmeve nga komisioni i ekspertëve.

Këshilli i Qarkut Vlorë me shkresën Nr.4648/3 prot, datë 06.06.2024 “Dërgim dokumentacioni për banesën e djegur të z.Jurgen Loli” ka dërguar preventivin e hartuar nga komisioni i ekspertëve, nga ku rezulton:

- Vlera e dëmeve në banesën e z.Jurgen Loli është 684.827 (gjashtëqind e tetëdhjet e katër mijë e tetëqind e njëzet e shtatë) lekë.
- Të miratojë vlerën financiare për humbjen e jetës të z.Thoma Loli në banesën e z.Jurgen Loli në masën : 500.000 (pesëqind mijë) lekë

Aktualisht Bashkia Vlorë ka mundësi financiare për të ndihmuar familjet për banesat e djegura.

Për sa më lart i kërkojmë Këshillit të Bashkisë të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesat e z.Jurgen Loli sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë dhe shpërblimin financiar i cili do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile të Bashkisë Vlorë.

DREJTOR

Adrian Vreshtazi

